



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VOĐE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

Autoriteti
Regulatori
Water Services

ARRU

Nr. prot./Prot. Br./ Prot. No. 589
Njësia/Jedinica/Unit D
Nr. shikres./Upis. Br./Reg. No.
Data/Datum/Date 08.09.2026
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, duke u mbështetur në nenin 4 paragrafi 3.1, nenin 16 dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe në nenin 4, nenin 9, nenin 12 dhe nenin 13 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. 496/DL, datë 30.07.2026, të Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., me adresë Sheshi “Bill Clinton”, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, me datën 08.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit

1. APROVOHET aplikacioni i NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit.
2. PËRTËRIHET/VAZHDOHET Licenca e Shërbimit e NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., dhe i lëshohet Licenca e Shërbimit me nr. L-09/2026-08, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11.09.2026 deri më 10.09.2031.
3. NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., me Licencën e Shërbimit nr. L-09/2026-08, autorizohet për ofrimin e shërbimit sipas kategorisë:
3.1. Kategoria D – Shërbimet e Ujit të Papërpunuar me Shumicë.
4. NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., autorizohet që, në kuadër të Kategorisë D, të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë të papërpunuar me shumicë, në përputhje me zonën dhe sistemin përkatës të shërbimit, si dhe kushtet e përcaktuara në Licencën e Shërbimit.
5. NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., obligohet që shërbimin për të cilin licencohet ta ofrojë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Rregulloren Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, aktet e nxjerra nga ARRU dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
6. NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Licencës së Shërbimit, obligohet të ruajë dhe përmbushë kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave është bërë përtëritja/vazhdimi i Licencës së Shërbimit.
7. NH “Ibër-Lepenc” Sh.A., obligohet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Memorandumi i Mirëkuptimit, i bashkëngjitur këtij vendimi, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në të, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e tyre brenda afateve të parapara.

8. Licenca e Shërbimit me nr. L-09/2026-08 i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbën pjesë përbërëse të tij.

ARSYETIM

Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., si ofrues ekzistues i licencuar i shërbimit të ujit të papërpunuar me shumicë, ka paraqitur pranë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) aplikacionin për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, së bashku me dokumentacionin dhe dëshmitë përkatëse të kërkuara për zhvillimin e procedurës së licencimit.

Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit përcakton procedurën dhe kushtet për aplikimin dhe përtëritjen e licencës së shërbimit, ndërsa Rregullorja Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit përcakton procedurat, kriteret dhe kushtet konkrete për përtëritjen/vazhdimin e licencës së shërbimit. Në veçanti, neni 12 i Rregullores Nr. 16/2025 përcakton kushtet për përtëritjen/vazhdimin e licencës së shërbimit, ndërsa neni 13 përcakton vendimarrjen e Autoritetit pas shqyrtimit të aplikacionit.

Në zbatim të këtyre dispozitave, aplikacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit. Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka vlerësuar përmbushjen e kushteve të licencës, si dhe kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të aplikueshme për përtëritjen/vazhdimin e saj, duke përfshirë kapacitetet profesionale, teknike, operative, financiare dhe administrative të ofruesit.

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit është konstatuar se Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., ka paraqitur dokumentacionin dhe dëshmitë e nevojshme dhe i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, përfshirë kushtet që lidhen me kapacitetet për ofrimin e shërbimit, qëndrueshmërinë financiare, kapacitetet teknike dhe operative, si dhe përmbushjen e kushteve të licencës ekzistuese.

Në kuadër të këtij vlerësimi, është marrë në konsideratë natyra specifike e veprimtarisë së Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., e cila, për qëllime të kësaj licence, nuk licencohet për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit apo kanalizimit për konsumatorët fundorë, por për ofrimin e Shërbimit të Ujit të Papërpunuar me Shumicë, përkatësisht për Kategorinë D, sipas klasifikimit të shërbimeve të përcaktuar me Rregulloren Nr. 16/2025.

Rrjedhimisht, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kjo licencë lidhen me ofrimin e shërbimit të ujit të papërpunuar me shumicë, në kuadër të sistemit dhe zonës përkatëse të shërbimit dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në Licencën e Shërbimit dhe aktet rregullative të ARRU-së.

Në përputhje me nenin 4 të Rregullores Nr. 16/2025 dhe në bazë të aplikacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, është konstatuar se Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., i plotëson kushtet për t'u licencuar për Kategorinë D – Shërbimet e Ujit të Papërpunuar me Shumicë.

Pas përfundimit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacionit, dokumentacionit dhe dëshmive të paraqitura, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit ka vlerësuar se Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” Sh.A., i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara për

përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit për Kategorinë D dhe, rrjedhimisht, i ka rekomanduar ARRU-së përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit.

ARRU, duke marrë për bazë aplikacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, rezultatet e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore dhe rregullative, natyrën specifike të shërbimit për të cilin kërkohet licenca, si dhe rekomandimin e Komisionit, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit të Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" Sh.A., për Kategorinë D – Shërbimet e Ujit të Papërpunuar me Shumicë, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11.09.2026 deri më 10.09.2031.
Për arsyet e cekura më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- NH "Ibër Lepenc" Sh.A.;
- Të gjitha Departamenteve të ARRU;
- Njësisë për Inspektim.

